



Spitali Amerikan

Mijëra pacientë na kanë besuar shëndetin dhe jetën e tyre


Pacientët vijnë në Spitalin Amerikan me pritshmërinë e standarteve më të larta që mjekësia mund të ofrojë. Pacientët dhe familjarët e tyre e quajnë Spitalin Amerikan vendin e përkujdesjes, të besimit dhe shpresës, fjalë të fundit të mjekësisë, një dritë në fund të tunelit.

Numri i madh i pacientëve, besimi dhe shpresa që është krijuar ndër ta, flet shumë për ne. Flet për reputacionin e krijuar në gjashtë vite punë të ekipit të palodhur të spitalit. Flet edhe për pritshmërinë dhe përgjegjësinë e lartë para së cilës gjendemi çdo ditë për të justifikuar besimin e atyre që na kanë zgjedhur.

Të jesh lider dhe të vendosësh standartet në rang kombëtar dhe jo vetëm, për ne do të thotë të kesh zgjidhje për çdo kërkesë të çdo pacienti, t'u ofrosh atyre sistemin më eficient dhe teknologjinë më të lartë në mbështetje të profesionalizmit të stafit. Do të thotë të jesh gjithmonë disa hapa para e të mos ndalesh asnjë ditë së përmirësuarit dhe avancuarit nëpërmjet punës kërkimore dhe edukimit.

Stafi i Spitalit Amerikan është në punë të vazhdueshme në kërkim të perfeksionit në shërbimin që ofrojmë. Janë pikërisht profesionalizmi i padiskutueshëm i stafit dhe teknologjia e standarteve më të larta dy nga armët tona më të forta që bëjnë diferencë të madhe.

Klodian ALLAJBEU, M.D.
CEO





Lista e Shërbimeve të Spitalit Amerikan

06	Kardiologji	25	Neurologji
07	Kardiokirurgji	26	Onkologji
08	Kirurgji e Përgjithshme	28	Pneumologji
10	Proktologji	28	Alergologji
11	Gastroentereologji	29	Hematologji
12	Kirurgji Plastike	30	ORL
14	Ortopedi	32	Okulistikë
16	Gjinekologji - IVF	34	Dermatologji
18	Pediatri	36	Imazheri e Avancuar
19	Neonatologji	38	Shërbime Laboratorike
20	Nefrologji	40	Patologji - Histokimi
21	Urologji	41	Anestezi & Reanimacion
22	Endokrinologji	42	Shërbim Urgjence 24h
24	Rheumatologji	43	Check Up

Kardiologji

Guri i parë i themelit të Spitalit Amerikan, njëherazi edhe krenaria më e madhe e punës së gjithë këtyre viteve, i themeluar në një kohë që pacientët kardiakë linin vendin për t'u diagnostikuar dhe trajtuar jashtë për problemet e zemrës, kardiologjia e Spitalit Amerikan çeli një epokë të re në mjekësinë moderne shqiptare.

Ekipi i kardiologëve të talentuar ka trajtuar në vite mijëra pacientë të problematikave të ndryshme kardiakë, përfshirë edhe rastet më ekstreme të infarkteve akute të miokardit.

Me ekipin e gjerë të trajnuar në disiplinat përkatëse dhe me aparaturat më moderne, departamenti kardiologjisë mbulon me shërbim 24 orë në 7 ditë të javës çdo kërkesë të poliklinikës dhe urgjencave kardiakë duke i trajtuar në mënyrë medikale, me koronaroangiografi, stentime në rast nevoje, studim elektrofiziologjik, ablacion etj.

Përveç trajtimit medikal dhe metodave invazive, Departamenti i Kardiologjisë i ka kushtuar një vëmendje të veçantë edhe edukimit të pacientit lidhur me parandalimin dhe trajtimin në kohë të sëmundjeve kardiakë si edhe metodave imazherike moderne të ekzaminimit të zemrës siç janë angio skaner apo Calcium score; matje e pllakave sklerotike në enë të gjakut.

- Vizitë kardiakë
- EKG
- EKO zemre transtorakale
- EKO zemre transezofageale
- EKO stres test
- HOLTER i ritmit
- HOLTER i presionit arterial
- Koronaroangiografi (planifikuar ose urgjente)
- Implantim i stenteve
- Implantim i Pacemaker-it
- Studim elektrofiziologjik
- Ablacion
- Kateterizim i zemrës



Kardiokirurgji



Që prej 5 vitesh Spitali Amerikan është lideri i vetëm dhe i padiskutueshëm i kardiokirurgjisë në Shqipëri. Mbi 2200 pacientë i kanë besuar zemrat ekipit të Prof. Dr. Neyyir Tuncay Eren. Nga kirurgjia e aortës në kirurgjinë valvulare, nga defektet e lindura në bypaset multiple, të gjitha patologjitë kardiake që kanë nevojë për ndërhyrje kanë zgjidhje në një adresë të vetme.

ike etj.)

arteriet karotide

venat varikoze

Kirurgji e Përgjithshme

Që prej shekujsh kirurgjia e përgjithshme ka qenë një nga degët më të avancuara të mjekësisë dhe vazhdon të ruajë rëndësinë e saj dhe të avancojë çdo ditë në metodikë.

Sot, Spitali Amerikan, me ekipin e tij të zgjedhur të kirurgëve shqiptarë e të huaj, shënon gamën më të gjerë të ndërhyrjeve kirurgjikale të realizuara në vend.

Një vënd të veçantë në punën e ekipit të kirurgjisë së përgjithshme në Spitalin Amerikan zë kirurgjia onkologjike që luan një rol kyç në trajtimin adekuat të pacientëve të diagnostikuar me kancer.

Kirurgjia e Përgjithshme është departamenti që punon ngushtë me shumë departamente të tjera, si; Gastroenterologjia, Imazheria e Avancuar dhe Invazive, ORL, Urologjia, Gjinekologjia, Patologjia, Onkologjia, Ortopedi-Traumatologjia, Endokrinologjia etj.

OPERACIONET MBI PATOLOGJITË KIRURGIKALE TË EZOFAGUT

- Polipe të ezofagut
- Kancer ezofageal
- Ngushtime të ezofagut
- Achalazi

OPERACIONE GASTRIKE (TË STOMAKUT)

- Trajtim kirurgjikal i ndërlikimeve të ulcerës peptike
- Trajtim i neoformacioneve si kanceri gastrik
- Korrigjimin e patologjive të stomakut të operuar më parë

OPERACIONE TË INTESTINIT (ZORRËS SË HOLLË)

- Tumore intestinale dhe të mezenterit
- Okluzione të ndryshme

OPERACIONE KOLO-RECTALE

- Trajtim i kancerit të kolonit dekster
- Trajtim i kolonit transvers
- Trajtim i kolonit sinistër dhe rectosigmoidien

OPERACIONE TË RRUGËVE BILIARE DHE HEPARIT (MËLÇISË)

- Kalkulozë e kolecistës (Gurë në tëmth)
- Kalkulozë e rrugëve biliare
- Ikter mekanik beninj dhe malinj
- Echinokok heparin
- Absceset e heparit

KIRURGJIA E PANKREASIT

- Trajtimi i pseudokisteve të pankreasit
- Trajtimi i tumoreve të pankreasit

TUMORET E INDEVE TË BUTA

- Trajtimi i lipomave
- Trajtimi i formacioneve të buta të lëkurës dhe nënlëkurës

KIRURGJI E PARETIT ABDOMINAL

- Hernie inguinale
- Hernie umbilikale
- Hernie incizionale (laparocelat)

KIRURGJI ENDOKRINE

- Gjëndrat tiroide
- Trajtimi e strumave
- Adenomat toksike
- Morbus Basedow

KIRURGJI E GJËNDRAVE PARATIROIIDE

KIRURGJI SURENALE (MBIVESHKORE)

- Tumore kortikale të surenales

URGJENCË KIRURGIKALE 24 ORË

- Abdomen akut
- Apendicit akut
- Kolecistit akut
- Peritonit
- Okluzione
- Hernie të inkarceruara
- Drenim të absceseve të ndryshme




Në rastet e politraumave me dëmtime multiple të organeve ekipi i kirurgjisë së përgjithshme është në gatishmëri në bashkëpunim me koleget e Ortopedisë, Neurokirurgjisë, Urologjisë, Kardiokirurgjisë e Gjinekologjisë për të shërbyer 24 orë në të dyja njësitë e urgjencës në Spitalin Amerikan në Tiranë.

Megjithatë kirurgjia e përgjithshme nuk konsiston vetëm në ndërhyrjet brenda në sallë por ka një rol të veçantë edhe në trajtimet pre dhe post operatore të pacientëve në ndjekje intensive, ushqyerjen parentale dhe enterale, ndjekjen kirurgjikale të infeksioneve etj.

Proktologji

- Konsultë proktologjike
- Diagnostikim i sëmundjeve të zorrës së trashë, si hemorroidet, fisura anale, cyst pylonidal, abcesi perianal dhe coxygeal, kancer i zorrës së trashë, tumoret presakrale, polipet, prolapsi i rektumit, trauma e kompleksit sfinkterial, sëmundjet inflamatore, coxycodynia, sindromi i zorrës së iritueshme (IBS), hidradeniti supurativ, condiloma anale, pruritusi anal, formacionet e ndryshme ano perianale, incontiniencia anale, etj
- Anoskopi, proktoskopi, rektosigmoidoskopi rigide, fibrokolonoskopi
- Biopsi e anorectumit
- EKO endoanale 2D
- Trajtime konservative bashkëkohore
- Operacione me teknika bashkëkohore në trajtimin e sëmundjeve të ndryshme të zorrës së trashë, nga të cilat THD, PPH në trajtimin e sëmundjes hemorroidale, që aktualisht disponohen në Shqipëri vetëm nga Spitali Amerikan.
- Konsulta të rregullta postoperatore sipas protokolleve.



Gastroenterologji

- Vizitë gastroenterologjike
- Endoskopi e sipërme digjестive / Ezofagogastroduodenoskopia
- Rektosigmoidoskopi
- Kolonoskopi totale
- Polipektomi endoskopike
- Heqje e trupave të huaj
- Skleroterapi e vatrave hemorragjike gastrike



Ky departament ka si qëllim t'u shërbejë pacientëve me probleme të sistemit tretës me profesionistët më të specializuar si dhe aparaturat e teknologjisë më moderne. Shërbimi i gastroenterologjisë në Spitalin Amerikan është bazuar fuqishëm në metodat më të fundit endoskopike si në diagnostikim ashtu edhe në trajtimin kirurgjikal të problemeve të ndryshme. Në këtë aspekt departamenti i gastroenterologjisë punon ngushtë me klinika të tjera si radiologji, kirurgji e përgjithshme dhe onkologji.

Duke qenë se Shqipëria është një vend i prekur ndjeshëm nga sëmundjet e sistemit tretës dhe rrugëve hepatobialiare, ky departament ka fituar një rëndësi të veçantë edhe në trajtimin e mëlçisë dhe problemeve të saj, duke e bërë kështu Spitalin Amerikan të parën qendër të gatshme për të kryer transplantin e mëlçisë.

Kirurgji Plastike

Që prej 2008, qindra pacientë i kanë besuar Spitalit Amerikan zgjedhjen e tyre për një trup më të bukur, një pamje më perfekte apo revizionimin e një dëmtimi të mëparshëm.

Kirurgjia Plastike e Spitalit Amerikan, me një fluks që kalon 40 ndërhyrje në muaj, jo vetëm u ka dhënë përgjigje kërkesave të atyre që kërkojnë një pamje më të sofistikuar por edhe ka thyer përfundimisht tabunë që kirurgjia plastike bëhet jashtë vendit.

KIRURGJI KOZMETIKE

- Abdomenoplasti (zvogëlim kirurgjikal i barkut)
- Lifting i krahut
- Rikonturim i trupit
- Lifting i trupit
- Botox
- Rritje e gjoksit
- Lifting i gjoksit
- Rikonstruksion i gjoksit
- Zvogëlim i gjoksit
- Lifting i vetullave (ngritje e vetullave)
- Peeling kimik
- Kirurgji e nofullës
- Dermoabrazion
- Kirurgji e veshit

- Kirurgji e qepallave të syve
- Lifting i fytyrës
- Implante të fytyrës
- Mbjellje flokësh
- Injeksione mbushëse
- Liposuction
- Mikrodermabrazion

KIRURGJI RIKONSTRUKTIVE

- Kirurgji e buzës dhe qiellzës
- Kirurgji e dorës
- Kirurgji e deformimeve të nofullës
- Revizionim i shenjave të plagëve
- Kirurgji e kancerëve të lëkurës
- Zëvendësim indi



Ortopedi

Një nga departamentet padiskutueshmërisht më të suksesshme të Spitalit Amerikan është Ortopedi - Traumatologjia. E bazuar në ekspertizën e një ekipi të përzgjedhur mjekësh të huaj e shqiptarë, kjo klinikë, që prej 3 vitesh gëzon një reputacion profesional të lartë.

Me shërbimin 24 orë dhe traumat e shumta që trajton, Departamenti i Ortopedisë e ka shndërruar Spitalin Amerikan në një qendër të rëndësishme politraume.

Nga ndërhyrjet artroskopike me qëndrim minimal në spital, në tumoret e kockave, nga kirurgjitë e defekteve të lindura në fëmijë e të rinj, në traumat e aksidenteve të rënda, mjekët ortopedë të SA janë në gjendje t'i përgjigjen maksimalisht çdo kërkesë që paraqet gjendja e pacientit.

- Amputacion, dezartikulation
- Anomalitë kongjenitale
- Art. Pelvike dhe gluteale
- Artrodezat
- Artroskopia e bërrylit, kyçit të dorës
- Artroskopia e gjurit
- Artroskopia e shpatullës
- Gipsi dhe atelet (gipsi plastik)
- Imobilizimi i artikulacioneve me anestezi
- Kirurgjia e artikulacioneve, kirurgji e hapur
- Kirurgjia e ekstremiteteve, mikrokirurgjia
- Kirurgjia e laseracionit të indit të butë
- Nxjerrja e implantit
- Ortopedi pediatrike
- Osteomieliti
- Osteotomitë
- Reponimi i mbyllur i luksacioneve
- Riparimi i luksacioneve të përsëritura
- Trajtimi i luksacioneve
- Trajtimi kirurgjik i frakturave



Gjinekologji dhe IVF

Qendra e Gruas në Spitalin Amerikan është një nga klinikat më të avancuara të kësaj strukture. Me gamën e plotë të shërbimeve, ndërhyrjeve kirurgjikale dhe trajtimit të infertilitetit, kjo qendër është e vetmja në llojin e vet dhe në cilësinë e shërbimit që ofron.


Në departamentin e Shëndetit të Gruas dhe Lindjeve, që prej themelimit të Spitalit Amerikan 2, trajtohen të gjithë problemet gjinekologjike; tumoret e organeve riprodhuese të gruas, çrregullimet e menopauzës, ndjekja normale e shtatzënive, ndjekja e shtatzënive me rrezik të shtuar etj. Një vend i veçantë në vëmendjen e ekipit të drejtuar nga Prof. Dr. Hakan Şatıroğlu i është dhënë trajtimit të infertilitetit në çiftet që prej vitesh jo vetëm kanë pritur të bëhen prindër, por edhe e kanë kërkuar shtatzëninë e shumëpritur jashtë Shqipërisë.

SHËRBIMET

- Vizitë gjinekologjike
- Vizitë gjatë shtatzënisë
- Ndjekje gjinekologjike pas lindjes
- Ultrasonografi ECHO
- Ndjekje e shtatzënisë me ultrasonografi ECHO
- Ekzaminime me ultrasonografi doppler gjatë shtatzënisë
- Bi test, tripple test dhe amniocentezë gjatë shtatzënisë
- Lindje
- PAP test
- Kolposkopi dhe biopsi
- Laparoskopji
- Histeroskopji
- Histerosalpingografi (HSG)
- Vendosje e aparateve mbrojtëse në mitër
- Testet rutinë të Check Up-it gjinekologjik
- Kirurgji ditore
- Kirurgji madhore të tumoreve, etj
- Eliminim i shtatzënisë defektive në javët e para

TRAJTIME TË:

- Çrregullimeve të ciklit menstrual
- Çrregullimeve gjatë menopauzës
- Masave tumorale të organeve gjenitale
- Çrregullimeve të sekrecioneve vaginale
- Sëmundjeve seksualisht të transmetueshme
- Planifikimit familjar dhe aplikimit të metodave mbrojtëse





Me një laborator embriologjik unik në Ballkan, ekipi i ekspertëve të infertilitetit ka mundur shtatzëninë e shumë çifteve me probleme nga më të ndryshmet të drejtuara në këtë qendër, jo vetëm nga brenda vendit por edhe nga vendet fqinje.

Rëndësi e veçantë në punën e këtij departamenti i është kushtuar diagnostikimit dhe trajtimit të hershëm të kancerit duke aplikuar metodat më të fundit kirurgjikale dhe të trajtimit Post Op në bashkëpunim me departamentin e onkologjisë.

Për ato që përgatiten të jenë nëna të reja, Qendra e Gruas dhe Fertilitetit ka hartuar një program të veçantë të ndjekjes dhe edukimit gjatë shtatzënisë, që më pas pason edhe me ndjekjen e bebes pas lindjes dhe edukimin për kujdesin ndaj saj. Të gjitha këto, të përfshira në një program të vetëm që ka për qëllim ndjekjen e shtatzënisë dhe lindjen në kushtet më të mira të mundshme.

Pediatri

Departamenti i Peditrisë dhe Neonatologjisë në Spitalin Amerikan i shërben gjithë pacientëve të vegjël të grupmoshave nga 0 deri në 16 vjeç.

Ekipi i profesionistëve të peditrisë dhe neonatologjisë kujdesen për shëndetin e fëmijëve në bashkëpunim me koleget e tyre specialistë të fushave të tjera, duke mundësuar jo vetëm ndjekjen në poliklinikë por edhe hospitalizimin e tyre.

Në të njëjtën kohë Spitali Amerikan 2, ku Peditria dhe Neonatologjia janë të vendosura, shërben si një qendër e fuqishme 24 orëshe për urgjencat peditrike të çfarëdo natyre.

- Vizita peditrike
- Ndjekje e historikut të detajuar
- Ndjekje e historikut të ushqyerjes, rritjes dhe zhvillimit
- Teste diagnostifikuese



Neonatologji

Një vend të veçantë nën drejtimin e këtij departamenti zë Neonatologjia dhe Reanimacioni i Neonatëve, një investim unik në llojin e tij, si nga ana njerëzore, ashtu edhe nga aparaturat tepër të avancuara që disponon. Në sajë të këtij pavioni, Spitali Amerikan është në gjendje të presë lindje problematike dhe premturë të natyrave nga më të vështirat.

Çdo neonat i lindur ose që paraqitet për kontrollet e hershme në Spitalin Amerikan, i nënshtrohet një kontrolli të detajuar dhe ekzaminimeve metabolike që janë rutine në spitalet me prestigjioze në botë dhe që në Shqipëri mundësohen vetëm nga laboratoritë e këtij spitali. Vaksinimi i fëmijëve në Spitalin Amerikan bëhet konform rregulloreve të kombinuara të Ministrisë së Shëndetësisë së Shqipërisë dhe Shoqatës Botërore të Shëndetit.



Nefrologji

Një nga departamentet pararojë, që bashkë me kirurgjinë e përgjithshme i kanë dhënë Spitalit Amerikan emrin e qendrës së vetme të transplanteve në vend.

Me 55 transplante të suksesshme dhe 64 shtretër hemodialize që shërbejnë 24 orë në tre prej spitaleve tona, ky departament ka shënuar stadin më të avancuar në trajtimet që fusha e nefrologjisë moderne ofron sot në botë.

- Diagnostikim i sëmundjeve apo çrregullimeve të veshkave
- Çrregullime të traktit urinar dhe përmbajtjes së urinës
- Probleme të shkaktuara nga hipertensioni
- Insuficiencë renale akute ose kronike
- Aplikime hemodialize ne rastet akute
- Biopsi e veshkës
- Hemodializë dhe dializë peritoneale
- Transplant i veshkave



Urologji

- Konsultë urologu
- Ekzaminimet urologjike
- Ndërhyrje në aparatën urinar
- Uro-Onkologji
- Urologjia pediatrike
- Urologji femërore
- Urologjia rekonstruktive dhe traumat
- Urologji Endoskopike
- Litotripsi perkutane
- Urologji laparoskopike
- E.S.W.L (Litotripsi)
- Trans Rectal Biopsy e prostatës
- Kirurgji e vogël

Urologjia në Spitalin Amerikan u shërben të rriturve dhe të miturve me metoda diagnostike, terapeutike dhe kirurgjikale në të gjitha njësitë e spitalit në Tiranë. Kirurgjia laparoskopike dhe konservative e kanë bërë Departamentin e Urologjisë në mënyrë të padiskutueshme pararojë jo vetëm në vend, por edhe në rajon.

Eliminimi i gurëve në veshka me metodat më moderne, pa patur nevojën e një ndërhyrjeje të mirëfilltë kirurgjikale, u ka shërbyer qindra pacientëve në vitet e fundit. Trajtime të tjera si kirurgjitë e tumoreve, trajtimi i impotencës, kirurgjitë e prostatës etj, janë nga fushat kryesore për të cilat ekipi i Spitalit Amerikan është çdo ditë e më i kërkuar.



Endokrinologji

Shërbimi i Endokrinologjisë pranë Spitalit Amerikan ofron një shërbim mjekësor për të gjitha çrregullimet hormonale dhe metabolike. Staf i mjekësor i endokrinologjisë është i kualifikuar për të menaxhuar patologji të tilla si diabeti i sheqerit, obeziteti (mbipesha) dhe patologji të tiroides. Çrregullime të yndrave në gjak, patologjitë e hipofizës, gjëndrës mbiveshkore të sferës riprodhuese, të metabolizmit të kalciumit, osteoporozën dhe çrregullime të tjera metabolike. Qëllimi ynë është identifikimi i shkakut apo shkaqeve me natyrë endokrine për një trajtim sa më të hershëm dhe adekuat.

Të gjitha shërbimet në këtë departament sigurohen falë një ekipi mjekësh multidisiplinar, të cilët kujdesen për menaxhimin e plotë të rastit dhe zhvillimin e planeve individuale të trajtimit.

NDJEKJE E DIABETIT

- Diabeti i sheqerit tip 1 dhe 2
- Diabeti i shtatëzënisë
- Sindroma Metabolike
- Hipoglicemia

NDJEKJE E OBEZITETIT

- Diagnostikim dhe trajtim i etiologjisë së obezitetit
- Terapi dietike

NDJEKJE E ÇRREGULLIMEVE TË TIROIDES

- Hipertiroidizmi
- Hipotiroidizmi
- Struma
- Nodulat e Tiroides
- Kanceri e Tiroides
- Testet e hormoneve
- Ultrasonografia e tiroides
- Citopunksion i nodulit të tiroides (biopsi)

NDJEKJE E DEGJENERIMEVE KOÇKORE

- Osteoporoza/ Osteopenia
- Hiperparatiroidizmi
- Hipoparatiroidizmi

NDJEKJE E ÇRREGULLIMEVE TË HIPOFIZËS

- Adenoma e Hipofizës
- Hipopituitarizmi
- Galaktore
- Diabeti Insipid

ÇRREGULLIME TË GJËNDRAVE MBIVESHKORE

- Adenoma e Mbiveshkores
- Hiperadrenalizmi
- Hipoadrenalizmi

SËMUNDJET E GONAVEDE

- Sindroma e Ovarit Polikistik
- Sindroma Turner
- Hipogonadizmi
- Infertiliteti

NDJEKJE E MENOPAUZËS

- Diagnostikim dhe trajtim i menopauzës
- Testet hormonale
- Mamografi
- PAP-test
- DEXA (densitometria e kockave)



Rheumatologji

Departamenti i reumatologjisë disponon stafin dhe ekspertizën e nevojshme për trajtimin e problemeve reumatizmale të thjeshta dhe të komplikuar. Shumë sëmundje të tjera reumatizmale të kombinuara gjejnë trajtim në bashkëpunim me departamentin e ortopedisë, neurologjisë apo fizioterapisë së Spitalit Amerikan.

- Vizite Reumatologu
- Osteodensitometri
- Kapilaroskopi
- Fizioterapi
- Ekzaminime laboratorike/diagnostikuese



Neurologji

SËMUNDJET QË TRAJTOHEN

- Sëmundjet vaskulare cerebrale (Aksidentet vaskulare cerebrale) – Ishemia dhe hemorragjia cerebrale; Diagnostikimi i malformacioneve të vazave cerebrale (Aneurizma, AV, kavernoma etj)
 - Diagnostikimi dhe trajtimi i patologjisë së karotideve (medikamentoz dhe kirurgjikal)
 - Sëmundjet Neurodegjenerative
 - Sëmundja e Parkinson; Sindromet Demenciale; Ataksitë spinocerebellare; Skleroza amiotrofike laterale; Sëmundja e Huntington etj.
- Epilepsia (sindromet epileptike)
 - Dhimbjet e kokës
 - Patologjitë spinale dhe të nervave periferike (dëmtime medulare spinale, hernie diskale, neuropati të etiologjive të ndryshme)
 - Patologjitë muskulare



Departamenti i Neurologjisë në Spitalin Amerikan ofron diagnostikimin dhe mjekimin e të gjithë gamës së sëmundjeve neurologjike.

Gjithashtu mbështetur nga ekzaminimet më të sofistikuara imazherike dhe stafi i specializuar i radiologjisë që merret me interpretimin e tyre (MRI, MRA CT, Angio-CT, ECHO Doppler, radiografi) dhe laboratorit të specializuar, mundësohet diagnoza neurologjike e shpejtë dhe e sigurt.

Në Spitalin Amerikan funksionon Laboratori i Neuroelektrofiziologjisë ku kryhet EEG, Video EEG dhe polisonografi.

Për shumë diagnoza ofrohet jo vetëm konsulta ambulatorë, por edhe shtrimi dhe trajtimi në kushtet adekuate të Spitalit Amerikan.

Onkologji

Departamenti i onkologjisë kujdeset për diagnostikimin dhe përpilimin e planit të trajtimit të pacientëve që vuajnë nga sëmundja e kancerit.

Departamenti i onkologjisë në Spitalin Amerikan ka në bazë të punës së tij bashkëpunimin, punën në ekip që është edhe çelësi i suksesit në luftën kundër kësaj sëmundjeje.

Një ekip multidisiplinar i përbërë nga mjekët onkologë, patologë, radiologë, kirurgë dhe mjekë të specialiteteve të tjera sipas nevojës, punojnë së bashku për të përcaktuar trajtimin e duhur për çdo pacient.

NË SPITALIN AMERIKAN TRAJTOHEN:

- Kanceri i Traktit Gastrointestinal
- Kanceri i Gjirit
- Kanceri i Mushkërive
- Kanceri i Sistemit Geniturinar
- Kanceri Gjinekologjik
- Limfoma
- Sarkoma
- Melanoma

DIAGNOSTIKIMI I KANCERIT

Diagnostikimi, hapi i parë dhe shumë i rëndësishëm në trajtimin e kësaj sëmundjeje bëhet duke përdorur metodat më të fundit, sa më pak invasive për pacientin, duke përfshirë stereotactic core biopsy dhe procedurat kirurgjikale laparoskopike.

KONSULTA

Gjatë bisedës me mjekun jepen të gjitha informacionet e nevojshme për sëmundjen, planin e trajtimit dhe efektet anësore të trajtimit. Stafi i departamentit të onkologjisë është i gatshëm për të ndihmuar në këtë periudhë të vështirë duke punuar si skuadër dhe pacienti është pjesa më e rëndësishme e kësaj skuadre.

KIMIOTERAPIA

Kimioterapia është thjesht administrimi i disa medikamenteve për të luftuar kancerin. Shumica e pacientëve pasi marrin kimioterapinë largohen nga spitali (terapi ditore), por ka edhe skema kimioterapie që e kanë të domosdoshme qëndrimin në spital. Në disa raste mund të vendoset edhe një port-cut që është një facilitet i konsiderueshëm në marrjen e disa skemave të kimioterapisë.



Pneumologji - Alergologji

Shërbimet e Pneumologjisë dhe Alergologjisë në Spitalin Amerikan jo vetëm komplementojnë mirë njëra-tjetrën, por edhe janë në bashkëpunim të vazhdueshëm me departamentet e tjera. Një rol të veçantë luan shërbimi i pneumologjisë në ndjekjen e pacientëve post op të moshave madhore, në trajtimin adjutant të tumoreve të mushkërisë, si dhe në mbarëvajtjen e laboratorit të apnesë së gjumit në bashkëpunim me disiplina të tjera.

Një nga avantazhet kryesore që i jep superioritet shërbimit të alergologjisë në Spitalin Amerikan është ndihma që laboratorit qendror i jep me gamën tejet të gjerë të testeve alergologjike në gjak, si në fëmijë edhe në të rritur.

SËMUNDJET E TRAJTUARA

- sëmundje pulmonare obstruktive kronike
- sëmundje të ndryshme parenkimale dhe vaskulare të mushkërive
- imazheri të avancuar (rreze-x dhe tomografi të kompjuterizuar)
- testet e funksioneve pulmonare
- bronkoskopi fiberoptike

SËMUNDJET E TRAJTUARA

- astma
- riniti alergjik
- sinusiti
- urtikaria


DIAGNOSTIKIM I PLOTË

- histori e detajuar e alergjisë
- histori e dietës
- ekzaminim fizik
- teste laboratorike për diagnostikim



Hematologji

- Hemoglobinopati
- Anemi të lindura
- Anemi të fituara
- Linfoma
- Leuçemi
- Çrregullime te koagulimit



ORL

Në shërbimin e ORL, e gjithë puna e kryer në sajë të një teknologjie të avancuar, mbështetet në standarde të larta etike, mjekësore dhe akademike. Pacientëve që aplikojnë në ORL u ofrohet shërbimi i poliklinikës dhe hospitalizimi. Mikroskopia dhe teknologjia e sistemeve endovizuale përdoren gjerësisht për ekzaminimin e pacientëve të poliklinikës.

Trajtimi dhe rehabilitimi i pacientëve me ulje apo humbje dëgjimi bëhet në sajë të mbështetjes së një departamenti modern audiologjie. Riparimi i membranës timpanike të çarë, zëvendësimi i kockëzave të veshit me proteza dhe gjithë procedurat e tjera kirurgjikale të veshit, përfshirë edhe arritjen me të rëndësishme të viteve të fundit Implantin Koklear, janë ndërhyrje që kryhen rutinë nga ekipi i mjekëve të ORL në Spitalin Amerikan.

Ky shërbim përdor videoelektro-nistagmografi dhe testet kalorike për vlerësimin e gjendjes së pacientëve me marrje mendsh, si dhe metoda endoskopike për ekzaminimin e kordave vokale të pacientëve me çrregullime të zërit.

- Diagnostikim dhe trajtim i sëmundjeve të veshit
- Diagnostikim dhe trajtim i sëmundjeve të hundës
- Diagnostikim dhe trajtim i marrjes së mendjes
- Diagnostikim dhe trajtim i apnesë së gjumit
- Diagnostikim dhe trajtim i çrregullimeve të zërit
- Diagnostikim dhe trajtim i tumoreve të kokës dhe qafës
- Otorinolaringologjia e fëmijëve





Shumë probleme të lidhura me frymëmarrjen nga hunda, të cilat në mënyrë të konsiderueshme dëmtojnë cilësinë e jetës dhe shkaktojnë parehati tek pacienti, diagnostikohen dhe trajtohen suksesshëm duke përdorur dhe teknika endoskopike dhe mikroskopike.

Laboratori i gjumit ofron diagnostikimin dhe trajtimin e çrregullimeve të gjumit, gërhitjen dhe apnenë e gjumit. Këto sëmundje trajtohen me anë të pajisjeve të presionit pozitiv, ndërhyrjeve me radiofrekuencë në hundë, qiellzën e butë dhe rrënjën e gjuhës dhe metoda të tjera kirurgjikale.

Ky ekip kryen gjithashtu edhe ndërhyrje kirurgjikale me teknika moderne për tumoret e kokës dhe të qafës, si dhe ndërhyrje kirurgjikale të lidhura me rikonstrukcionin kozmetik dhe humbjet funksionale të lidhura me kirurgjinë për këto tumore.

Okulistikë

Qendra e syrit në Spitalin Amerikan ofron sot gamën më të gjerë të ekzaminimeve dhe ndërhyrjeve kirurgjikale që një klinikë moderne oftalmologjike mund të ofrojë.

Duke i shërbyer të miturve dhe të rriturve dhe duke kuruar të gjitha patologjitë e syrit, kjo qendër, është bërë referente jo vetëm në Shqipëri por edhe në rajon. Me stafin prej 6 mjekësh të kualifikuar në fusha të ndryshme, Spitali Amerikan – Qendra e Syrit ka realizuar për herë të parë shumë risi si: korrigjimin e numrit të syzave me lazer, eliminimin e kataraktës me fakoemulsifikim, transplantin e kornesë, trajtimin e keratokonusit, kirurgjinë vitreoretinale etj.

EKZAMINIME OFTALMOLOGJIKE

- Vizita okulistike për të rritur
- Vizita okulistike pediatrike edhe para moshës 1 vjeç
- Ekografi e syrit
- Fusha pamore
- Topografi e syrit (Pentacam®)
- Pakimetri korneale
- Angiografi me fluoreshinë
- Kontaktologji (Lente të buta dhe të forta të kontaktit)
- Vendosje e protezave okulare
- Tonometri automatike

NDËRHYRJE KIRURGJIKALE

- Operacione të perdes me ultratinguj (Phacoemulsifikim)
- Operacione me lazer për eliminimin e numrit të syzeve (LASIK / LASEK)
- Operacione me Lente Fakike (Artisan / Artiflex®) për korrigjimin e numrave ekstrem të syzave
- Trajtimi i Keratokonusit me Cross-linking Korneal
- Trajtimi i Keratokonusit me Unaza Korneale (Intacts®)
- Transplant i Kornesë
- Operacione të Retinës (Vitrektomi posteriore për sëmundje si: shkollitja e retinës, retinopatia diabetike, hemorragjitë vitreale, etj.)

- Operacione të tensionit të syrit (Glaukoma)
- Operacione të devijimit të syve (Strabismus)
- Operacione të pterigionit (Transplant konjuktival dhe Mitomicine C)
- Operacione të Kalazonit
- Operacione për kanalën e lotit (Dacryocystorhinostomia e jashtme dhe e brendshme) me tuba silikon
- Kirurgjia e kapakëve të syve

INJEKSIONE INTRAVITREALE

- Avastin®
- Lucentis®
- Triamcinolone

TRAJTIME ME LAZER

- Trajtim me lazer për retinopatinë diabetike
- Kapsulotomi me YAG – lazer
- Iridotomi me YAG - lazer



Dermatologji

Në Spitalin Amerikan diagnostikojmë dhe ndjekim në vazhdimësi trajtimet e kartelizuara të pacientëve për patologjitë dermatologjike të moshës pediatrike, sëmundjet kronike, diagnostikimin e patologjive malinje, trajtimin e patologjive të thonjve, flokëve, mukozës në gojë dhe infeksioneve gjenitale.

Praktika klinike bashkëvepron tërësisht me ekzaminimet laboratorike të një niveli të lartë dhe konsultat e mjekëve të specialiteteve të tjera për të arritur një diagnostikim dhe trajtim adekuat.

DERMOPATOLOGJIA

Personeli i kualifikuar me ndihmën e aparaturave laboratorike moderne kryen ekzaminimin dhe interpretimin e biopsive të lëkurës duke përcaktuar me saktësi detajet e ndryshimeve patologjike në nivelin mikroskopik. Më pas konfrontimi me planin klinik dhe konsultat me mjekun dermatolog e bëjnë më të thjeshtë diagnostikimin dhe mjekimin e duhur të pacientit.

Laboratori dermopatologjik është pjesë e një departamenti të tërë ku kryhen të gjitha testet dhe analizat më specifike.

KIRURGJIA DERMATOLOGJIKE

Procedurat e mëposhtme shpesh kryhen në bashkëpunim me specialistët e kirurgjisë plastike.

- Ekzicion të lezioneve malinje dhe beninje
- Trajtimi me krioterapi i shumë patologjive të lëkurës
- Trajtimet invazive të pacientëve me akne të gradës së dytë dhe të tretë

DERMATOLOGJIA KOZMETIKE

- Piling kimik
- Injeksionet e Botox
- Injeksione me fillër të ndryshëm
- Skleroterapi për teleangiektazitë dhe venat e vogla

TERAPIA ME LASER

- Shenjat që mbeten nga aknet
- Rigjenerimi i lëkurës në regjionin e qafës, kraharorit dhe duarve
- Melasma
- Lezionet e pigmentuara të lëkurës të lokalizuara kudo në trup
- Heqje tatuazhesh
- Rrudhëzat përreth syve
- Çikatricat kirurgjikale
- Keratozat aktinike



Imazheri e Avancuar

Një nga armët më të forta të një institucioni të mirë shëndetësor është pa diskutim imazheria e avancuar që thotë fjalën e fundit në diagnostikimin e shumë sëmundjeve dhe marrjen e vendimit për trajtimin e tyre.

Në Spitalin Amerikan stafi i mjekëve radiologë dhe teknikë të specializuar, bazuar edhe në aparaturat më moderne të imazherisë, ofrojnë maksimumin e precizionit në mbështetjen me imazhe të diagnostikimit të saktë.

- Tomografi e Kompjuterizuar (Skaner) 64 detektorë
- CT kardiake
- Rezonancë Magnetike 1.5 Tesla
- Shintigrafi
- Mamografi dixhitale
- Densitometri e kockës
- Ekografi / Doppler
- Grafi dixhitale





SIEMENS

Hospital American

Laborator

Departamenti i Laboratorit klinik – biokimik, mikrobiologjik dhe patologjik kryen suksesshëm suportin laboratorik të pacientëve ambulatorë në parandalimin dhe diagnostikimin e patologjive të ndryshme si dhe aplikimin e protokolleve laboratorike pre - koronarografi për pacientët kardiakë, pre – kimioterapi për pacientët onkologjikë, ndjekjen pre dhe post-operatore të pacientëve të kardiokirurgjisë, kirurgjisë së përgjithshme, kirurgjisë ortopedike e gjithë kirurgjive të tjera.

Duke qënë një qendër referente në shumë kirurgji të rëndësishme, Spitali Amerikan, i ka kushtuar një rëndësi të veçantë laboratorit imunohistopatologjik që i është besuar një stafi tepër të përzgjedhur. Në këtë mënyrë në çdo rast nevojë diagnostikimi dhe terapia e saktë mbështeten fuqishëm jo vetëm nga biopsia konvencionale por edhe nga metoda më e avancuar frozen, duke na lejuar të aplikojmë më së miri kirurgjinë konservative.

Pranë laboratorit të Spitalit Amerikan realizohen me sukses gjithashtu ekzaminimet e detajuara gjenetike, klinike dhe biokimike të pacientëve pre –transplant dhe monitorimi laboratorik frekuent i imunosupresorëve në këta pacientë pas transplantit.

- Teste rutinë
- Teste biokimike
- Teste hematologjike
- Teste hormonale
- Teste imunologjike
- Teste virusale
- Teste mikrobiologjike
- Teste alergjike
- Dozimi i medikamenteve
- Elektroforeza
- Teste të koagulimit
- Teste në urinë
- Teste toksikologjike
- Teste specifike të patologjive të ndryshme
- Paneli metabolik dhe elektrolitet
- Teste biokimike specifike
- Proteinat specifike
- Lipoproteinat dhe fosfolipidet
- Teste të detajuara të koagulimit
- Hematologjia laboratorike
- Teste laboratorike në urinë
- Teste laboratorike në feçe
- Teste laboratorike të likidit cerebrospinal
- Teste laboratorike të likidit articular
- Markuesit tumorale
- Teste laboratorike të patologjive imunitare
- Elektroforezat dhe imunoelektroforezat
- Dozimi i antigjeneve dhe antikorpeve hepatike
- Teste të patologjive virale dhe agjentëve të tjerë infeksioze
- Teste laboratorike sipas patologjive dhe procedurave mjekësore
- IgE specifike dhe intoleranca ushqimore
- Check up sipas moshës dhe seksit
- Testet patologjike
- Gjenetika prenatale dhe biologjia molekulare



Diagnostika prenatale dhe testet e avancuara të ndjekjes prenatale janë një tjetër risi që pacientet e gjejnë në Shqipëri vetëm në Spitalin Amerikan.

Qysh në fillimet e tij ky laborator është konceptuar dhe ndërtuar me teknologjinë më të fundit në fushën laboratorike totalisht automatike, të kompanive më të njohura. Këto aparatura tërësisht automatike minimizojnë në maksimum gabimet që sjellin metodat e mëparshme manuale. Bashkangjitur kësaj teknologjie është dhe paisja e këtij laboratori me sistemin informatik laboratorik (LIS-laboratory information system) që shman gabimet njerëzore në ngatërrimin e mostrave të gjakut të pacientëve dhe njëkohësisht në arshivimin e të gjithë rezultateve laboratorike të çdo pacienti. Këto rezultate janë disponibël në çdo moment kur pacientit i nevojiten për informacion të gjëndjes së tij shëndetësore apo për qëllime krahasuese të rezultateve laboratorike pre dhe post-terapeutike.

ME KRENARI LABORATORI I SPITALIT AMERIKAN MBAN I VETËM NË SHQIPËRI VULËN ÇERTIFIKUESE TË ISO 15189, STANDARTIT MË TË LARTË NË MENAXHIMIN E CILËSISË NË FUSHËN LABORATORIKE.

Lab. Patologjik - Histokimik

Një investim tepër serioz dhe i rëndësishëm që ka shoqëruar Spitalin Amerikan që prej fillimeve të punës ka qenë edhe Laboratori i Patologjisë. Tashmë një qendër referente në vendosjen e shumë diagnozave, ky laborator posedon një arsenal të fuqishëm mundësish ekzaminuese të indeve dhe qelizave. Duke qenë në bashkëpunim të vazhdueshëm me laboratorë të tjerë tepër prestigjioze në Stamboll dhe Dortmund, është arritur që çdo metodë histokimike, imunohistokimike, imunofluorosheike, FISH, PCR apo citogjenetike etj, t'i ofrohen pacientëve të Spitalit Amerikan dhe atyre që drejtohen në këtë laborator nga pothuajse e gjithë Shqipëria.

Një risi e rëndësishme e këtij laborator është edhe metoda "frozen section" që lejon ekzaminimin e menjëhershëm të një indit ndërkohë që pacienti është duke iu nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale. Në këtë mënyrë, ekipi i kirurgëve në kohë rekord dhe në një ndërhyrje të vetme mund të vendosë për një kirurgji konservative apo radikale në varësi të natyrës që shfaq indit.

- Biopsi e vogël, e mesme dhe e madhe
- Citologji
- Pap test
- Biopsi urgjente (ex tempore)
- Imunohistokimi
- Imunofluoreshencë
- FISH
- PCR
- Citogjenetike



Anestezi & Reanimacion

- Anestezi e ndërhyrjeve kirurgjikale
- Anestezi e ndërhyrjeve ditore
- Sedatim në metodat invazive diagnostikuese
- Sedatim në metodat invazive terapeutike
- Anestezi tek të miturit dhe fëmijët
- Sedatim tek të miturit dhe fëmijët
- Menaxhim i dhimbjeve në lindje
- Menaxhim i dhimbjeve kronike
- Menaxhim i dhimbjeve traumatike



Ekipi i Anesteziologjisë dhe Reanimacionit në Spitalin Amerikan mbështet me shërbim 24 orë të gjitha njësitë dhe të gjithë departamentet e tjerë të këtij spitali. Në varësi të llojit të ndërhyrjes, menaxhimit të dhimbjes apo moshës së pacientit ky ekip është i përbërë nga specialistë që mbulojnë të gjitha nevojat.

Duke patur parasysh shumëllojshmërinë e ndërhyrjeve kirurgjikale edhe madhore që kryhen në Spitalin Amerikan, ky ekip luan një rol të veçantë edhe në rikuperimin në kohë rekord dhe sipas protokolleve më të avancuara të pacientëve pas këtyre ndërhyrjeve kirurgjikale.

Urgjencë 24 orë

Në bashkëpunim me shërbimin e terapisë intensive, sallën e hemodinamikës, sallat e operacioneve, maternitetin, laboratorin, imazherinë e avancuar që janë 24 orë në shërbim, si dhe bazuar në përkushtimin maksimal të stafit të mjekëve dhe infermierëve, qendrat e urgjencës së Spitalit Amerikan janë bërë dyer ku shumë qytetarë, jo vetëm të kryeqytetit, trokasin për problemet emergjente shëndetësore.

Urgjenca përbën një hallkë esenciale në punën e Spitalit Amerikan pikërisht edhe për arsyen se është e vetmja qendër e urgjencës kardiovaskulare në vend, që u shërben pacientëve në rastet akute të infarktit të miokardit, aneurizmave të aortës etj, duke i transportuar këto raste në kohë rekord me ambulancë ose helikopter dhe duke i trajtuar edhe me koronaroangiografi, stentim apo ndërhyrje kirurgjikale nëse lind nevoja.

Shërbimi në shtëpi është një risi e kësaj qendre drejtuar të gjithë pacientëve që e dëshirojnë, por veçanërisht për rastet onkologjike, të dializës, post-kirurgjikale, moshat e treta, pacientët me sëmundje të rënda kronike etj.

Urgjenca e Spitalit Amerikan është një nga hallkat më të forta të menaxhimit të pacientëve në këtë strukturë. Me kapacitetin për të pritur çdo lloj urgjence; nga ato rutinë deri në ato më madhore si pasojë e traumave multiple apo aksidenteve, ky shërbim pranon rreth 700 urgjenca në muaj në dy njësitë 24 orëshe në Laprakë dhe Rruga e Dibrës, Tiranë.



Check Up

- Kontroll i përgjithshëm për femra
- Kontroll i përgjithshëm për meshkuj
- Kontroll periodik i thjeshtë/standard për femra
- Kontroll periodik i thjeshtë/standard për meshkuj
- Kontroll i ecurisë pas kancerit për femra
- Kontroll i ecurisë pas kancerit për meshkuj
- Kontroll kardiak
- Kontroll për diabetin
- Kontroll VIP për femra
- Kontroll VIP për meshkuj
- Kontroll Ultra për femra
- Kontroll Ultra për meshkuj
- Kontroll për të rinj
- Kontroll për fëmijë
- Kontroll gjatë shtatëzanisë

Kontrolli periodik i shëndetit është tepër i rëndësishëm për të evidentuar në kohë problemet para se ato të bëhen shqetësuese. Në këtë mënyrë pacienti ka të gjitha mundësitë që të reagojë në kohë dhe të marrë trajtimin e duhur pa qënë ende shumë vonë.

Me diagnostikimin dhe marrjen e trajtimit në kohën e duhur ju i shtoni vetes shancet për një jetë më të mirë, më të gjatë dhe më të shëndetshme. Moshë, gjinia, historiku familjar, mënyra e jetesës dhe lloji i rutinës së përditshme janë faktorë të rëndësishëm që formulojnë një check up të personifikuar, tamam si një kostum të qepur pas trupit në mënyrë që nga rezultatet e tij të përfitohet në maksimum.

Kanceri i kolonit, i gjirit apo prostatës, diabeti, sëmundjet kardiake, degjenerimet kockore si dhe shumë sëmundje të tjera mund të parandalohen lehtësisht me kontrole të përgjithshme periodike. Kushtojini disa orë në 6 muaj ose në 1 vit shëndetit tuaj dhe jetoni shëndetshëm për shumë më gjatë.





Përmbajtja e këtij publikimi është autentike dhe pronë e Spitalit Amerikan.
Ndalohet riprodhimi, përdorimi apo shpërndarja e pa autorizuar.

© **Spitali Amerikan 2012**